DALËSE-IZLAZNA-OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 351 -1201/II
Data Datum Date 23.11.2012

# Republika e Kosovës
## Republika Kosovo-Republic of Kosovo
### Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

---

Datë,21.11.2012
Nr. 351 -1201

**PËR:** Kadri Krasniqi, Rr. "Naim Beka", Ferizaj

**LËNDA:** Përgjigje në kërkesë

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar nga ju një kërkesë për të u informuar lidhur me statusin e një pompe të benzinës, pronë e Tahir dhe Naser Maloku, nga Ferizaji, e ndërtuar në lagjen ku ju banoni. Bashkangjitur në shkresë gjenden shkresat nga veprimet e ndërmarra nga ana e komunës së Ferizajt si; raportet e inspekcionit, vendimi për ndërprerjen e punimeve, si dhe shkresa tjera.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të kërkesës tuaj konstaton se;

- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, nuk është kompetente për zgjidhjen e kësaj çështje.
- Ne si ministri bëjmë mbikëqyrjen e akteve të përgjithshme të komunave që ndërlidhen me legjislacionin bazë për vetëqeverisje lokale, ndërsa çështje e ngritur nga Ju është çështje administrative, e cila duhet të trajtohet në bazë të Ligjit të Procedurës Administrative.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, është e gatshme të ju ofroj ndihme të nevojshme të gjitha institucioneve dhe qytetar ve te Republikës së Kosovës.

Me respekt,

**Slobodan Petrović,**
**Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MAPL,**

**Kopje:** *Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL-së*
*Drejtorëve të Departamenteve dhe Zyrave*
*Arkivit të MAPL-së.*

DALËSE-IZLAZNA-OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 351-1201/1
-III-
Data Datum Date 23.11.2012

# Republika e Kosovës

## Republika Kosovo-Republic of Kosovo

## Qeveria - Vlada – Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

Dana,21.11.2012
Nr. 351 -1201

**Za:** Kadri Krasniqi, Rr. "Naim Beka", Uroševac

**Predmet:** Odgovor na zahtevu

Poštovani,

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, je primilo jedan dopis od vas radi informisanja u vezi sa statusor jene benzinske pumpe ,vlasništvo Tahir i Naser Maloku, iz Uroševca, izgradjena u ulici gde vi stanujete. Uz dopis se namaze dokumenta o preduzetim merama od strane Opštine Ureoševac i to; izveštaji inspekcije, odluka o prekidu radova,kao i druge dopise.

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, u skladu sa svojim mandatom odredjenim po Zakonu za lokalnu samoupravu br. 03/L-040, dodatak XII Uredbe Vlade 02/2011 o poljima administrativne odgovornosti kabineta Premijera i Ministarstva, posle razmatranja vašeg zahteva konstatuje ;

- Ministarstvo administracije Lokalne samouprave nije nadležno za rešavanje ovoga pitanja.

- Mi kao ministarstvo vršimo nadgledavanje opštih akata opština koje se nadovezuju sa osnovnim zakonodavstvom za lokalnu samoupravu, pitanje koje ste vi pokrenuli je administrativo pitanje,koje treba da se tretira na osnovu Zakona o Administrativnoj Proceduri.

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, je spremno da pruži potrebnu pomoć svim institucijama i gradjanima Republike Kosovo.

S poštovanjem,

**Slobodan Petrović,**
**Zamanik Premijera i Ministar MALS-a,**

**Kopija:** *Besnik Osmani,Generalni Sekretar MALS-e*
*Direktorima uprava i kancelarija*
*Arhivi MALS-a*

Për: Ministrinë e Administratës dhe e Pushtetit Lokal
-Sekretarit Permanent të Ministrisë-
PRISHTINË

HYRSE-ULAZNA-INCOMING
REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVES VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Data / Datum / Date: 08. 11. 2012

| Njësia organizative | Nr. i Lëndës | Shtojca | Vlera |
|---|---|---|---|
| - III - | 351-1201 | | |

Nga: Kadri Krasniqi
Rruga "Naim Beka" p.n.
70000 Ferizaj

Lënda:

# KËRKESË

## PËR TË DITUR STATUSIN E POMPËS SË BENZINËS E NDËRTUAR JASHT LIGJIT DHE ATE PA LEJE NDËRTIMI

*/e cila gjindet në Rrugën "Naim Beka" p.n. në Ferizaj/,pronë e pronarëve Tahir dhe Naser Maloku nga Ferizaji*

Tahir dhe Naser Maloku kanë ndërtuar pompën e benzenes në Rrugën "Naim Beka" në Ferizaj aty kah viti 2009,aty ku janë të vendosura me dekada familje të tëra për të jetuar.Paraqitësi i kësaj kërkese me 13 anëtar të familjes jeton në afërsi shumë të madhe të pompës së ndërtuar në mënyrë të kundërligjëshme,i cili nuk disponon edhe Lejen e ndërtimit nga Organet kompetente të asaj kohe dhe aty për rreth janë të vendosur për jetesë edhe shumë familje,pompa e benzines në fjalë paraqet rrezik permanent për familjen time,por edhe të gjithë banorëve për rreth.

Unë si paraqitës i kësaj kërkese organet kompetente komunale në Ferizaj i kam NJOFTUAR se pompa e benzines e ndërtuar në lokacionin e cekur më lartë është duke u ndërtuar pa Leje dhe në kundërshtim me ligjin dhe se kompetentët janë të njoftuar se funkcionimi i kësaj pompe paraqet rrezik permanent ,pra */sikur të ishte një bombë e kurdisur/* që befasisht do të shkatrroj familjen time,por edhe banorët e lagjës për rreth,kurse për pasurinë e tyre most ë flasim.

**A THUA SE DUHET PRITUR QË TË SHKAKTOHET PASOJA,E PASTAJ TË INTERVENOHET**,si shtetas I këtiJ vendi pyes ku janë organet kompetentet të dalura nga vota e popullit që nuk ndërmmarin veprime PREVENTIVE,pa u shkaktuar pasojat ,sepse pas fatkeqsisë-pasojat janë të pa riparuesheme,por edhe të pa korigjueshme.

Derivatet e naftës dhe gazërat që lirohen gjatë shitjes së benzines,por edhe ndërtimi i asaj pompe pa leje ndërtimi në çdo kohë mund të pritet edhe të EKSPLODOJ me pasoja të pa parashikueshme.

Unë jam i vetëdijshëm,por edhe në konsulltim me ekspert juridik se Ministria e Administratës dhe e pushtetit lokal është kompetente,por ka edhe ingerenca për kontrollin e ligjshmërisë të Organeve lokale,pra të Komunave.

Përkitazi me ndërtimin e kësaj pompe të benzines në kundërshtim me ligjin kam njoftuar edhe Kryetarin e Komunës së Ferizajt z.Bajrush Xhemaili,por edhe

Kryeinspektorin komunal z. David Demaj dhe të njejtit pos asaj se janë të njoftuar për ndërtimin e paligjshëm të pompës së bezinës dhe pasojat e saja ata nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim për të ia ndalur hovin kësaj kundërligjshmërie dhe kam dyshime se zyrtarët kompetent solidarozohen me paligjshmërinë,madje më shtynë të dyshoj se në rastin konkret ka korrupcion dhe më bënë me dyshuar se institucionte e vendit tim –Kosovës janë në mbrojzje të biznesmenëve të pa ndërgjegjëshëm dhe se nuk janë në pozitat etyre të I mbrojnë qytetarët e ndershëm dhe familjet e dëshmuara për qështje kombëtare siq mendoj se është familja ime që çdo here ka qenë në nivel sa i pëket qështjes kombëtare.

Me anë të kësaj shlrese kërkoj nga ju zoti sekretar që të më dilni në ndihm dhe të shqyrtoni punën e organeve komunale dhe të ndërmerrnni veprime konformë kompetencës dhe së paku unë dhe familja ime të shpresoj se në këtë vend- ka një institucion që rrespekton ligjin dhe ka një zyrtar që punon për qytetraët ekëtij vendi.

Njëherit shkresa në formë njoftimi të shërbej si lajmërim serioz se diçka nuk është në rregull dhe kur të shkaktohen pasojat,apo kur të detyrohem, në vetëgjyqësi do të jet shumë vonë,dhe se kjo është një argument se Organet kompetente nuk mund të justifikohen se nuk kanë qenë detalisht të njoftuara.Pra nesër për çdo veprim arbitrar eventual këto shkresa do të më shërbejnë si qrgument se organet shtetërore nuk kanë qenë efikase dhe me vetëdije e kanë lejuar të keqen.Ministria e pushtetit lokal do të duhej ta përcjellë punën e pa ligjëshme të organeve komunale.Jam i gatshëm që sqarimet e mia?po qese më ftoni në bisedë/ të i shpjegoj detalisht edhe me gojë.

**Kemi pasur konsulltime edhe me Ekspert të kësaj fushe** dhe të njejtit gjithëher kanë dhënë mendimin profesional dhe e kanë potencuar rrezikun permanent që i kanoset kësaj familje nga ndërtimi dhe funkcionimi i Pompës së Benzinës

*.nga veprime të pa ligjshme të njerëzve të dyshimt të cilët nuk kanë mëshir e as rrespekt ndaj qytetarëve të vet,**por që fitimi i tyre madje me metoda të kundërligjëshme siq po shifet është mbi jetat e njerëzve,madje edhe familje të tëra.***

*Shtojcë e kësaj kërkese janë të gjitha shkresat me të cilat ju kam drejtuar organeve komunale dhe Qendrore për të më dale në ndihmë mua dhe familjes sime .*

*Më mbanë shpresa se së paku ju do të më pergjigjeni dhe të më kontaktoni nga fakti se besoj se drejtësia është në anën time.*

*Ju lutemi ta lexoni me vemendje dhe ta shiqoni pozitën e komunës së Ferizajit dhe të mos luani me popull e mos ekonsideroni popullin si të marr.*

***Shtojcë e kësaj Kërkese janë/***

*në tërësi dokumentacionet të cilat iu janë drejtuar organeve kompetente për rastin konkret,por fatkeqsisht pa ndonjë rezultat konkret.*

Ferizaj më 06.11.2012 vj.

*Paraqitësi i Kërkesës*

*Kadri Krasniqi* [signature]

*nga Ferizaji,Rruga"Naim Beka" p.n.*

*Tel.045-412-995*

FERIZAJ

# KUVENDI KOMUNAL
# FERIZAJ

DREJTORIA PËR PUNË TË INSPEKSIONIT

13. Nr. 351/073
Date: 17.07.2009.

## PROCESVERBAL

Gjatë kontrollës së inspeksionit të Ndërtimtaris ëtë: TAHIR MALCKU.
, i lindur më 1946 në LISOCK. KAMENICË me banim të përhershëm në FERIZAJ. Rr. „ NAIM BEKA" Nr. -; nr. personal
i përpiluar më 17.07.2009, në FERIZAJ. Rr. „ NAIM BEKA" në ora 12[32]

Prezent:
NASER MALCKU.

Inspektori-ët
1. XHEMAJL TAHIRI
2. LIMET AJLAZI

Me rastin e kontrollimit është konstatuar se:

INSPEKCIONI I NDËRTIMTARISË SIPAS ANKESËS SË PALËS 11-384-7054 TË DATËS 16.07.2009 DOLI NË VENDIN E NGJARJES (VENDPUNNATE) DHE KONSTATOI:

I NJEJTI KA FILLUAR PUNIMET NDËRTIMORE PA LEJE TË ORGANIT KOMPETENT- DREJTORISË PËR URBANIZËM PRONË, GJEODEZI DHE KADASTER.

PUNËT E KRYERA: JANË LARGUAR OBJEKTET E VJETRA SI DHE ËSHTË HAP (KRYER GËRMIM) NË THELLËSI = 2,70 m' ME DIMENZIONE = 5,00 x 11,00 m', NË BAZË ËSHTË VENDOSUR ZHAVOR SI DHE JANË KRYER KALLUPET PËR BAZË.

URDHËROHET PALA - INVESTITORI QË MENJËHERË TË I NDËRPRET PUNËT NDËRTIMORE DHE NË AFAT PREJ 20 DITËVE TË PREZENTOI LEJEN (DOKUMENTACIONIN KOMPLET) TË VËRTETUAR NGA ORGANI KOMPETENT.

NËSE PALA - NUK VEPRON SIPAS KËSAJ QË U CEK NË PROCESVERBAL, DO TË PASOJNË MASAT LIGJORE.

Procesverbali është lexuar me zë palës dhe i njejti deklaron

Procesverbali është përpiluar në tri ekzemplarë identikë, prej të cilave njëri i është dorëzuar palës

Pala

Inspektori-ët
1. [signature]
2. [signature]

2

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

DREJTORIA PËR PUNË TË INSPEKTORIATIT
UPRAVA ZA INSPEKCIJE
DEPARTMENT OF INSPECTION
Inspekcioni i ndërtimtarisë

11-nr.354/073
datë 20.07.2009

Inspekcioni i ndërtimtarisë në bazë të nenit **38,55** të **Ligjit për Procedurën Administrative Nr.02/L-28**,nenit **74** i Statutit të Komunës dhe neni **68** të **Ligjit të ndërtimit (Nr.2004/15)** të Kuvendit të Kosovës muarr këtë:

## V E N D I M

I URDHËROHET: **Tahir Maloku** i lindur më --.--.1946 në fsh.Lisock - Kamenicë, me banim në Ferizaj rr."Naim Beka" nr./, që **menjëherë** të i ndërprej punët ndërtimore dhe në afat prej **20** dite të prezentoi dokumentacionin komplet, të vërtetuar nga Drejtoria për urbanizëm ,pronë, gjeodezi dhe kadastër, për objektin e filluar apo të kthej objektin në gjendje fillestare (të mëparshme).Objekti ndodhet në rr." Naim Beka" në Ferizaj.

II Nëse pala nuk vepron sipas pikes **I** të këti Vendimi do të ndërmerren të gjitha masat e parapara me ligj. Rrënimi dhe kthimi në gjendjen e mëparshme, do të kryhet nga organi, e që shpenzimet i bartë vetë pala.

## A r s y e t i m

Inspekcioni i ndërtimtarisë,gjatë kontrollës së jashtëzakonshme me datën 17.07.2009 në rrugën "Naim Beka" në Ferizaj ,tek pala në fjalë ka konstatuar se i njejti nuk posedon leje nga organi kompetent- Drejtoria për urbanizëm ,pronë gjeodezi dhe kadastër ,andaj hartoi procesverbal 11-nr.354/073 ,ku konstatoi gjendjen faktike.

Është kryer gërmimi në thellësi ≈ 2.70m' , me dimenzione ≈ 5.00x11.00m'. Në bazë të bodrumit është vendosë shtresë zhavori ,si dhe janë kryer kallupet për betonim të bazës.

Me këtë rast pala në fjalë ka bërë shkelje të dispozitave të nenit **63** të Ligjit të ndërtimit **(Nr.2004/15)** të Kuvendit të Kosovës, në bazë të të cilit organi i Inspekcionit të ndërtimtarisë urdhëron **pezullimin (ndërprerjen)** e punëve ndërimore dhe prezentimin e dokumentacionit apo kthimin në gjendjen e mëparshme brenda afatit të parapare .

Pasi që i përmenduri nuk ka prezentuar lejen (dokumentacionin e vërtetuar nga organi kompetent), u vendos si në dispozitiv të këti Vendimi.

**KËSHILLA JURIDIKE**: Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej **8 dite** nga dita e pranimit të këtij Vendimi, MMPH-së (Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor) në Prishtinë, permes të këtij organi .

KUVENDI KOMUNAL SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY 02-A FERIZAJ UROŠEVAC

**Inspektori i ndërtimtarisë:**
Xhemajl Tahiri

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

DREJTORIA PËR PUNË TË INSPEKTORIATIT
UPRAVA ZA INSPEKCIJE
DEPARTMENT OF INSPECTION
Inspekcioni i ndërtimtarisë

11-nr.354/073
datë: 20.07.2009

# FLETËDORËZIM

| | Kujt i dërgohet shkresa | | Data e marrjes dhe nënshkrimi i marrësit | Nënshkrimi i dorëzuesit |
|---|---|---|---|---|
| | Emri e mbiemri ose titulli | Rruga e numri | | |
| **Vendim** | Tahir Maloku | rr."Naim Beka" nr./,- Ferizaj | 24.08.2009 | |

4

FERIZAJ

**KUVENDI KOMUNAL**
**FERIZAJ**

DREJTORIA PËR PUNË TË INSPEKSIONIT

Nr. 354/091

Date: 24.08.2009.

# PROCESVERBAL

Gjatë kontrollës së inspeksionit të Ndërtimtaris të: TAHIR MALOKU, i lindur më 1946 në LISOCK KAMENICË me banim të përhershëm në FERIZAJ Rr. „NAIM BEKA" Nr. –, nr. personal ______
i përpiluar më 24.08.2009., në FERIZAJ, Rr. „NAIM BEKA" në ora $11^{00}$

Prezent:

______

______

Inspektori-ët

1. XHEMAJL TAHIRI
2. RIFAT HASHANI

Me rastin e kontrollimit është konstatuar se: PALA - INVESTITORI NË FJALË KA ZBATUAR URDHËRAT E VENDIMIT TË INSPEKCIONIT PËR NDËRPRERJE TË PUNIMEVE NDËRTIMORE DHE KTHIM NË GJENDJEN E MËPARSHME - PJESËRISHT, PUNËT E KRYERA: ËSHTË RRAFSHUAR TERENI SI DHE ËSHTË MBYLLË BODRUMI (PJESËRISHT). NË MOMENTIN E KONTROLLIT NUK PUNOHEJ POR EDHE NUK MUNDËM TË KONTAKTOJMË PRONARIN.

Procesverbali është lexuar me zë palës dhe i njejti deklaron ______

Procesverbali është përpiluar në tri ekzemplarë identikë, prej të cilave njëri i është dorëzuar palës

Pala

______

Inspektori-ët

1. [signature]
2. [signature]

FERIZAJ

**KUVENDI KOMUNAL**
**FERIZAJ**

DREJTORIA PËR PUNË TË INSPEKSIONIT

14 Nr. 354 / 139
Date: 19. 10. 2009.

# PROCESVERBAL

Gjatë kontrollës së inspeksionit të Ndërtimtarisë të: NASER MALOKU.
, i lindur më 02. 03. 1971 në FERIZAJ. me banim të përhershëm në FERIZAJ Rr. „NAIM BEKA" Nr. - , nr. personal
i përpiluar më 19.10.2009. , në FERIZAJ. Rr. „NAIM BEKA" në ora 11[50]

Prezent:
NASER MALOKU.

Inspektori-ët
1. XHEMAJL TAHIRI
2. ISMET AJVAZI

Me rastin e kontrollimit është konstatuar se: PALA – INVESTITORI NË FJALË KA KRYER PUNËT NDËRTIMORE – PA LEJE TË ORGANIT KOMPETENT – DREJTORISË PËR URBANIZËM, PRONË, GJEODEZI DHE KADASTËR.
PUNËT E KRYERA: JANË KRYER PUNËT KENTOLLORE (VENDOSJA E REZERVARËVE DHE GYPAVE PËRCJELLËS) SI DHE OBJEKTI PËRDHESË ME PLLAKË (BAZË TË KATIT TË PARË) ME DIMENZIONE = 7,00 x 10,00 m'. JANË TË VENDOSUR EDHE KONSTRUKCIONI METALIK PËR MBULOJË (KAPRIATAT) E MBËSHTETUR NË OBJEKT.
URDHËROHET PALA – INVESTITORI QË MENJËHERË TË I NDËRPREJ PUNËT NDËRTIMORE DHE NË AFAT PREJ 15 DITËVE TË PREZENTOI LEJE (DOKUMENTACION KOMPLET) TE ORGANI I INSPEKCIONIT PËR VAZHDIMIN E PUNËVE APO TË KTHEJ OBJEKTIN NË GJENDJEN FILLESTARE (TË MËPARSHME).
NËSE PALA NUK VEPRON SIPAS KËTIJ QË U CEK NË PROCESVERBAL, DO TË PASOJNË MASAT LIGJORE.

Procesverbali është lexuar me zë palës dhe i njejti deklaron

Procesverbali është përpiluar në tri ekzemplarë identikë, prej të cilave njëri i është dorëzuar palës

Pala [signature]

Inspektori-ët
1. [signature]
2. [signature]

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

DREJTORIA PËR PUNË TË INSPEKTORIATIT
UPRAVA ZA INSPEKCIJE
DEPARTMENT OF INSPECTION
Inspekcioni i ndërtimtarisë

11-nr.354/139
datë 21.10.2009

**Inspekcioni i ndërtimtarisë** në bazë të nenit **38,55** të **Ligjit për Procedurën Administrative Nr.02/L-28**,nenit 74 i Statutit të Komunës dhe neni **68** të **Ligjit të ndërtimit (Nr.2004/15)** të Kuvendit të Kosovës muarr këtë:

## V E N D I M

I **URDHËROHET: Naser Maloku** i lindur më 02.03.1971 në Ferizaj, me banim në Ferizaj rr."Naim Beka" nr./, që **menjëherë** të i ndërprej punët ndërtimore dhe në afat prej 15 dite të prezentoi LEJE (dokumentacionin komplet), të vërtetuar nga Drejtoria për urbanizëm ,pronë, gjeodezi dhe kadastër, për objektin në ndërtim apo të kthej objektin në gjendje fillestare (të mëparshme).Objekti ndodhet në rr." Naim Beka" në Ferizaj.

II Nëse pala nuk vepron sipas pikes **I** të këti Vendimi do të ndërmerren të gjitha masat e parapara me ligj. Rrënimi dhe kthimi në gjendjen e mëparshme, do të kryhet nga organi, e që shpenzimet i bartë vetë pala.

## A r s y e t i m

Inspekcioni i ndërtimtarisë,gjatë kontrollës së rregullt me datën 19.10.2009 në rrugën "Naim Beka" në Ferizaj ,tek pala në fjalë ka konstatuar se i njejti nuk posedon leje nga organi kompetent- Drejtoria për urbanizëm ,pronë gjeodezi dhe kadastër ,andaj hartoi procesverbal 11-nr.354/139 ,ku konstatoi gjendjen faktike.

Janë kryer punët nëntoksore (vendosja e rezervarëve dhe gypave përcjellës) për pompë benzine.si dhe objekti përdhesë me pllakë (bazë të katit të parë) me dimenzione ≈ 7,00 x 10,00 m'.Janë të vendosura edhe konstrukcionet metalike për mbuloja (kapriata),e mbështetur në objekt.

Me këtë rast pala në fjalë ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 63 të Ligjit të ndërtimit **(Nr.2004/15)** të Kuvendit të Kosovës, në bazë të të cilit organi i Inspekcionit të ndërtimtarisë urdhëron **pezullimin (ndërprerjen)** e punëve ndërimore dhe prezentimin e dokumentacionit apo kthimin në gjendjen e mëparshme brenda afatit të paraparë .

Pasi që i përmenduri nuk ka prezentuar lejen (dokumentacionin e vërtetuar nga organi kompetent), u vendos si në dispozitiv të këti Vendimi.

**KËSHILLA JURIDIKE**: Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej **8 dite** nga dita e pranimit të këtij Vendimi, MMPH-së (Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor) në Prishtinë, permes të këtij organi .

Inspektori i ndërtimtarisë:

Xhemajl Tahiri

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

DREJTORIA PËR PUNË TË INSPEKTORIATIT
UPRAVA ZA INSPEKCIJE
DEPARTMENT OF INSPECTION
Inspekcioni i ndërtimtarisë

11-nr.354/139
datë: 21.10.2009

# FLETËDORËZIM

| | Kujt i dërgohet shkresa | | Data e marrjes dhe nënshkrimi i marrësit | Nënshkrimi i dorëzuesit |
|---|---|---|---|---|
| | Emri e mbiemri ose titulli | Rruga e numri | | |
| Vendim | Naser Maloku | rr."Naim Beka ", nr./ - Ferizaj | 22.10.2009 [signature] | [signature] |

7

FERIZAJ

**KUVENDI KOMUNAL**
**FERIZAJ**

DREJTORIA PËR PUNË TË
INSPEKSIONIT

1ł. Nr. 354 / 160
Date: 11.12.2009.

# PROCESVERBAL

Gjatë kontrollës së inspeksionit të Ndërtimtarisë të: NASER MALOKU.
, i lindur më 02-03-1971 në FERIZAJ me banim të përhershëm në FERIZAJ Rr. „NAIM BEKA" Nr. , nr. personal
i përpiluar më 11.12-2009. , në FERIZAJ. Rr. „NAIM BEKA" në ora 14^00

Prezent:
AGRON BERISHA.

Inspektori-ët
1. XHEMAJL TAHIRI
2. NIMET ADVARI

Me rastin e kontrollimit është konstatuar se: PALA – INVESTITORI NË FJALË KA VAZHDUAR PUNËT NDËRTIMORE EDHE PAS VENDIMIT PËR NDËRPRERJE TË PUNIMEVE – PA LEJE NDËRTIMORE NGA ORGANI KOMPETENT – DREJTORIA PËR URBANIZËM, PRONË GJEODEZI DHE KADASTËR.
PUNËT E KRYERA! ËSHTË KRYER OBJEKTI KOMPLET JANË NË PËRFUNDIM PUNËT E FASADËS PËR OBJEKT (POMPË BENZINE). JANË PA PËRFUNDUAR PUNËT E PLLAKOS (MBI DHE) DHE INSTALIMET.
ME KËTË RAST INSPEKTORI I NDËRTIMIT VENDOS SHIRITIN DHE SHENJËN ZYRTARE PËR MBYLLJE TË PUNISHTES DERI NË PREZENTIM TË DOKUMENTACIONIT KOMPLET PËR LEJE NDËRTIMI DHE LEJEN.

Procesverbali është lexuar me zë palës dhe i njejti deklaron SE KËRKESËN PËR LEJE NDËRTIMORE E KEMI BËRË NË DREJTORINË E URBANIZMIT DHE PROJEKTIN E KEMI DORËZU NË MINISTRI EMERGJENCE, AMBIENTI DHE ENERGJETIKËS DHE PRESIM PËRGJEGJE NGA TA, PASI ENDE NUK KEMI PËRGJEGJE NGA URBANIZMI DHE SE PËR KËTË ARSYE E KEMI VAZHDUAR PUNËN.

Procesverbali është përpiluar në tri ekzemplarë identikë, prej të cilave njëri i është dorëzuar palës

Pala

Inspektori-ët
1.
2.

8

KUVENDI KOMUNAL
FERIZAJ

DREJTORIA PËR PUNË TË INSPEKSIONIT

13. Nr. 354/162
Date: 17-12-2009

# PROCESVERBAL

Gjatë kontrollës së inspeksionit të Ndërtimtarisë të: NASER MALOKU, i lindur më 02.03.1971 në FERIZAJ, me banim të përhershëm në FERIZAJ Rr. „NAIM BEKA" Nr. –, nr. personal ____
i përpiluar më 17.12.2009., në FERIZAJ. në ora 13³⁰

Prezent: Rr. „NAIM BEKA"

Inspektori-ët
1. XHEMAJL TAHIRI
2. ISMET ADVATI

Me rastin e kontrollimit është konstatuar se: PALA – INVESTITORI NË FJALË KA VAZHDUAR PUNIMET NDËRTIMORE (PUNËT FINALE – FASADUESE) EDHE PAS VENDOSJES SË SHIRITIT DHE SHENJËS ZYRTARE PËR MBYLLJE TË PUNISHTES – PA PREZENTUAR LEJE NDËRTIMORE.
NË MOMENTIN E KONTROLLËS SHIRITI DHE SHENJA NUK KANË QENË, AS PUNËTORËT E AS PRONARI – INVESTITORI.
JANË KRYER DISA PUNË FINALE NË MBULOJEN E POMPËS (KONSTRUKCIONIT METALIK) DHE OBJEKTIT.

Procesverbali është lexuar me zë palës dhe i njejti deklaron ____

Procesverbali është përpiluar në tri ekzemplarë identikë, prej të cilave njëri i është dorëzuar palës

Pala ____

Inspektori-ët
1. [signature]
2. [signature]

9

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

FERIZAJ

DREJTORIA PËR PUNË TË INSPEKTORIATIT
UPRAVA ZA INSPEKCIJE
DEPARTMENT OF INSPECTION
Inspekcioni i ndërtimtarisë

11-nr.354/139
datë 18.12.2009

| | |
|---|---|
| DATA/DATE/DATUM | 18.12.2009 |
| NR/BR. | 11-nr.354/139 |

| | |
|---|---|
| PER/TO/ZA | PROKURORISË KOMUNALE në Ferizaj |
| PERMES/THROUGH/PREKO | Arhivës |
| NGA/FROM/OD | Inspeksioni i ndërtimtarisë |
| LENDA/SUBJECT/SUBJEKAT | Kallzim Penal |

Në bazë të nenit 322 alinea 1 të Ligjit të Procedurës Penale,paraqesim:

Lëndën për : **KALLZIM PENAL**

KUNDËR: **Investitorit : Naser Maloku i lindur 02.03.1971 në Ferizaj, me banim në Ferizaj ,rr"Naim Beka" nr./ ,**

**vend-ndërtimi rr."Naim Beka" në Ferizaj.**

Për shkak se :Investiori i lartëpërmendur ka vazhduar punët ndërtimore ne objektin afarist( pompë benzine) edhe pas ndërprerjes së punëve ndërtimore (mbylljes së punishtes) me shirit dhe shenjë zurtare - pa prezentuar dokumentacion (leje për ndërtim).

Me këtë shkresë iu bashkangjesim fotokopje dokumentacionin e ndërrmarë nga ana e inspektorit të ndërtimit :

Procesverbali 11-nr.354/139 i dates: 19.10.2009,
Vendimi 11-nr.354/139 i dates: 21.10.2009, me fletëdorëzim,
Procesverbali 11-nr.354/160 i datës 11.12.2009,
Fotot për shiritin e vendosur ( 4 fletë),
Procesverbali 11-nr.354/162 i datës 17.12.2009,
Fotot pas largimit të shiritit (3 fletë)

Insp. i ndërtimtarise:
Xhemajl Tahiri

10

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

DREJTORIA PËR PUNË TË INSPEKTORIATIT
UPRAVA ZA INSPEKCIJE
DEPARTMENT OF INSPECTION
Inspekcioni i ndërtimtarisë

11-nr.354/139
datë: 18.12.2009

# FLETËDORËZIM

| | Kujt i dërgohet shkresa | | Data e marrjes dhe nënshkrimi i marrësit | Nënshkrimi i dorëzuesit |
|---|---|---|---|---|
| | Emri e mbiemri ose titulli | Rruga e numri | | |
| **Kallzim penal** | **Prokuroria publike Komunale -Ferizaj** | rr."Dëshmorëte Kombit", nr./ - Ferizaj | 18.12.2009 | |

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

DREJTORIA PËR PUNË TË INSPEKTORIATIT
UPRAVA ZA INSPEKCIJE
DEPARTMENT OF INSPECTION
Inspekcioni i ndërtimtarisë

11-nr.354/139-D
datë 18.12.2009

**Drejtoria për punë të Inspekcionit-inspekcioni i ndërtimtarisë**, sipas procedures Kundërvajtëse Administrative dhe Gjobave ,kunder investitorit Naser Maloku nga.Ferizaj, për shkak të Kundërvajtjes nga neni 70 pika 12 e Ligjit të Ndërtimit Nr.2004/15 dhe nenit 12 pika 2 të Udhëzimit Administrativ Nr.01/06, e në harmoni me nenin 68 të të njejtit Ligj, dhe nenit17 pika 1 të Udhëzimit administrative nr.01/06 me datën 18.12.2009 merr këtë :

# VENDIM

I përmenduri Naser Maloku i lindur më 02.03.1971 në Ferizaj ,me banim të përhershëm në Ferizaj rr."Naim Beka",nr./, investitor i objektit në ndërtim në rr."Naim Beka" i cili edhe pas mbylljes së punishtes me shirit dhe shenjë zyrtare ka vazhduar punët ndërtimore (punët finale) - pa prezentuar Leje ndërtimi(dokumentacionin e vërtetuar nga organi kompetent),te inspekcioni i ndërtimtarisë,andaj:

## Është përgjegjës

Sepse me datën 17.12.2009 nga ana e organit të Inspeksionit të ndërtimtarisë ,është vërtetuar me procesverbal 11.nr.354/162 ,se ka vazhduar punët ndërtimore në punishten e mbyllur- pa prezentuar leje ndërtimore dhe dokumentacionin tjetër përcjellës, me çka ka kryer Kundervajtje Administrative si investues nga neni 12 pika 2 e Udhzimit Administrativ Nr.01/06 të Ligjit të Ndërtimit Nr.2004/15, andaj në bazë të dispozitave të theksuara Ligjore:

## DËNOHET

**Me denim në të holla në shumë** prej **800 €** (me fjalë **teteqind euro**).

Denimin e shqiptuar në të holla , sipas Udhzimit Administrativ Nr.01/06, i përmenduri duhet ta paguaj në afat prej **8 ditësh në Bugjetin e Konsoliduar të Kosovës.**

Pas kalimit të këti afati, për çdo vonesë paguhet kamata **2 % për 1 muaj**.

## ARSYETIM

Gjatë kontrollës së rregulltë, inspeksioni i ndërtimtarisë me datën 17.12.2009, në rr." Naim Beka", në Ferizaj ,te investitori Naser Maloku është vërejtur se i njejti ka vazhduar punët ndërtimore ,në punishten e mbyllur pa prezentuar leje të organit kompetent- Drejtorisë për Urbanizëm,Pronë,Gjeodezi dhe Kadastër, tek inspekcioni i ndërtimtarisë. Të njejtit i është lëshuar Vendimi 11-nr.354/139 i datës 21.10.2009 për ndërprerje të punëve ndërtimore, paisje me leje dhe prezentim në afat prej 15 dite ,mirëpo nuk është përfillur ,por janë vazhduar punë ndërtimore – pa prezentuar dokumentacion të vërtetuar.Me datë 11.12.2009 është vendosë shiriti dhe shenja zyrtare, për mbyllje të punishtes (ndërprerje definitive të punës), por prap është vazhduar-pa prezentuar lejen ndërtimore.

Për shqiptimin e këtij denimi u murrën parasysh të gjitha rrethanat e parapara sipas Ligjit dhe Udhëzimit Administrativ në fjalë e në bazë të të cilave iu shqiptua denimi i theksuar më lartë.

**Këshilla Juridike**:Kundër këtij Vendimi mund të ushtërohet ankesë MMPH-së (Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinorë) në Prishtinë, në afat prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të këtij Vendimi, përmes këtij organit pa pages takse, ankesa nuk e shtynë ekzekutimin e këti Vendimi.

**Inspektori i ndërtimtarisë:**

Xhemajl Tahiri

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

DREJTORIA PËR PUNË TË INSPEKTORIATIT
UPRAVA ZA INSPEKCIJE
DEPARTMENT OF INSPECTION
Inspekcioni i ndërtimtarisë

11-nr.354/139-D
datë: 18.12.2009

# FLETËDORËZIM

| | Kujt i dërgohet shkresa | | Data e marrjes dhe nënshkrimi i marrësit | Nënshkrimi i dorëzuesit |
|---|---|---|---|---|
| | Emri e mbiemri ose titulli | Rruga e numri | | |
| **VENDIM** | **Naser Maloku** | rr."Naim Beka" nr./ - Ferizaj | 22-12-09 [signature] | [signature] |

13

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

DREJTORIA PËR PUNË TË INSPEKTORIATIT
UPRAVA ZA INSPEKCIJE
DEPARTMENT OF INSPECTION
Inspekcioni i ndërtimtarisë

11-nr.354/139
datë 23.12.2009

Drejtoria për punë të Inspekcionit i KK Ferizaj, duke vendosur në bazë të nenit 109,116,118,119 dhe 120 Ligji i Procedurës Administrative dhe nenit 97 Nr.02/L-28/2005, nenit 74 të Statutit të KK- Ferizaj 01.nr. 33, muarr:

# KONKLUZË
## PËR LEJIMIN E EKZEKUTIMIT

**I. VËRTETOHET** se Vendimi i Drejtorisë për punë të Inspekcionit -Inspeksionit të ndërtimtarisë **11-Nr.354/139** i dates **21.10.2009**, bëhet i plotfuqishëm në bazë të nenit **64** të Ligjit të ndërtimit **2004/15**, prandaj lejohet ekzekutimi i tij në mënyrën që është paraparë sipas Vendimit.

**II.** Shpenzimet procedurale dhe të ekzekutimit do të caktohen me akt të veçant.

**III.** Ankesa kundër kësaj konkluze nuk e shtyn ekzekutimin.

### Arsyetim

Vendimi i Drejtorisë për punë të Inspekcionit **11-Nr.354/139**, i dates **21.10.2009**, është bërë i plotfuqishëm (ekzekutueshëm) me datën **13.11.2009**, me të cilin urdhërohet: **Naser Maloku** nga Ferizaji, me banim në Ferizaj rr."Naim Beka" nr./,që të veproj në bazë të Vendimit - të rrënoi objektin në tërësi dhe të kthej terenin në gjendjen fillestare (të mëparshme).

Pasi që i përmenduri në afatin e caktuar nuk i ka përmbushur obligimet nga Vendimi i inspekcionit të ndërtimtarisë (nuk ka prezentuar dokumentacion për objektin në ndërtim dhe nuk e ka kthyer ate në gjendjen fillestare),por ka vazhduar ndërtimin,u vendos si në dispozitiv të kësaj konkluze.

**Obligohet pala që në afat prej 8 dite të zbatoi konkluzionin –të rrënoi objektin dhe kthej terenin në gjendjen fillestare (zbatim vullnetar), pas kalimit të këtij afati demolimi dhe largimi do të kryhet nga organi ,e që shpenzimet i bartë pala (investitori), sipas pikes II të këti konkluzioni.**

Inspektori i ndërtimtarisë:

Xhemajl Tahiri

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

14

DREJTORIA PËR PUNË TË INSPEKTORIATIT
UPRAVA ZA INSPEKCIJE
DEPARTMENT OF INSPECTION
Inspekcioni i ndërtimtarisë

11-nr.354/139
datë: 23.12.2009

PERSONI NUK ISHTE ATY / ISHTE NË UDHTIM ZYRTARË JA LASHË PUNTORIVE PA NËNSHKRUE. 28. 12. 2009.

# FLETËDORËZIM

| | Kujt i dërgohet shkresa | | Data e marrjes dhe nënshkrimi i marrësit | Nënshkrimi i dorëzuesit |
|---|---|---|---|---|
| | Emri e mbiemri ose titulli | Rruga e numri | | (signature) |
| **Konkluzë për lejimin e ekzekutimit** | **Naser Maloku** | rr."Naim Beka, nr./ - Ferizaj | | |

# Të jetosh afër pompave të karburanteve mund të ju shkaktojë kancer, paralajmërojnë studimet

Botuar më, 7 shkurt 2011 - 07:58 | Shkruar nga Neelam Goswami

Studimet e reja paralajmërojnë se të jetosh afër pompave të benzinës paraqet një rrezik të madh për shëndetin. Këto studime pohojnë se pompa e benzinës afër jush e rrit rrezikun e sëmurjes nga kanceri.



Rreziqet nga karburantet janë të dokumentuara mirë në hulumtimet e mëhershme, të cilat sugjerojnë se pikat e karburanteve mund të jenë problematike për banorët e afërt.
Një hulumtim i paradokohshëm sugjeroi se jetesa afër një pikje karburantesh apo një garazhe karburantesh mund të rritë rrezikun e një leukemie akute në fëmijëri për 400 për qind. Një hulumtim tjetër ka sugjeruar se jetesa afër pompave të karburanteve çon deri te problemet me frymëmarrje.

**Jeta afër pompave të karburanteve është e dëmshme**

Tani, studimi më i fundit nga hulumtuesit Spanjollë sugjeron se pompat e karburanteve mund të jenë të dëmshme për njerëzit që jetojnë afër, posaçërisht për ata që jetojnë në një sipërfaqe prej 100 metrave nga pompa e karburanteve.
Në studimet e tyre, hulumtuesit zbuluan se ndërtesat që gjenden në një sipërfaqe prej 100 metrave nga pompa e karburanteve janë të ekspozuara ndaj ndotjes të dëmshme. Ata në ato shtëpi faktikisht kanë gjetur gjurmë të rritura të materieve kimike që shkaktojnë kancerin.
Marta Doval, hulumtuese në Universitetin e Murcias në Spanjë, dhe bashkëpunëtorët e saj kanë zbuluar se ajri në pompat e karburanteve dhe afër tyre ishte i helmuar nga rrezatimet që dalin nga karburantet e avulluara; për shembull, karburantet e padjegura nga ngarkimi she shkarkimi i karburanteve, rimbushja dhe derdhjet e lëngshme.
Telegrafi i Britanisë së Madhe citon Dovalin që thotë "Disa përbërës organikë që transmetohen me ajër, siç janë benzeni, i cili e rrit rrezikun e kancerit, në pompat e benzinës janë regjistruar mbi nivelin mesatar për zonat urbane ku trafiku është burim parësor i rrezatimit".

**Hollësitë e studimit**

Për studimin e tyre, ekipi i studiuesve bëri matjen e niveleve të ndotjes "tipike në trafik" në zona të ndryshme urbane në qytetin e Murcias, dhe llogariti koeficientet e nivelit të përbërësit aromatik të quajtur (benzen) dhe hidro-karbonit a (n-hexane) në tri pompa të karburanteve, sipas raportit të gazetës Telegraf duke cituar edhe deklaratën e Universitetit të Murcias.

PËRKTHYES - INTERPRET GJYQËSOR · ANGLISHT · SHQIP · ANGLISHT · GJYKATA E QARKUT NË PRISHTINË · Mentor Abdullahu · PRISHTINA DISTRICT COURT · ENGLISH · ALBANIAN · ENGLISH · COURT INTERPRETER - TRANSLATOR

"Disa përbërës organikë që transmetohen me ajër, siç janë benzeni, i cili e rrit rrezikun e kancerit, në pompat e benzinës janë regjistruar mbi nivelin mesatar për zonat urbane ku trafiku është burim parësor i rrezatimit," citon Dovalín gazeta ScienceDaily që thotë

"Në të tri rastet ne kemi marrë rezultatet në distancën maksimale prej 100 metrave, edhe pse distanca mesatare ku ky kontaminim ka efekt është 50 metra," tha bashkë studiuesi Enrique González.

**Ndikimi varet nga numri i pompave të karburanteve**

Megjithatë, distanca në të cilën pompat e benzinës pushojnë së ndikuari varet nga numri i pompave, sasia që e nxjerrin nga ato pompa, intensiteti i trafikut, struktura e rrethinës dhe kushtet atmosferike.

"Sa më e kontaminuar që është zona afër pompës së karburanteve si pasojë e shkaktarëve tjerë (trafiku), aq më i vogël është ndikimi i dy ndotësve nga pompa e karburanteve," përfundon autori i studimit.

PËRKTHYES - INTERPRET GJYQËSOR
ANGLISHT - SHQIP - ANGLISHT
GJYKATA E QARKUT NË PRISHTINË
Mentor Abdullahu
PRISHTINA DISTRICT COURT
ENGLISH - ALBANIAN - ENGLISH
COURT INTERPRETER - TRANSLATOR

# Living near petrol pumps can give you cancer, study warns

POSTED Mon, 02/07/2011 - 07:58 | POSTED BY Neelam Goswami Last edited by Silky Chandvani on Mon, 02/07/2011 - 08:16

Living near petrol stations can pose significant health hazards, warns a new study. It claims that petrol pump near your home can raise your cancer risk.



Fuelling health risks are well documented in previous researches, suggesting gas stations can be a problem for nearby residents.

An earlier research suggested that living near a petrol station or garage may increase the risk of acute childhood leukaemia by 400 percent. Another research has suggested that living very close to the gas stations leads to respiratory problems.

**Living near petrol pumps is harmful**
Now, the latest study by Spanish researchers suggests that petrol pumps could be a health hazard for people living nearby, especially those living within a 100m radius of the petrol pumps.

In their study, the researchers found that buildings situated within a 100m radius of the service stations are exposed to potentially harmful pollution. They actually found raised traces of a cancer-causing chemical in such homes.

Marta Doval, a researcher at the University of Murcia in Spain, and his associates found that the air at petrol stations and in their immediate surroundings was affected by emissions stemming from evaporated vehicle fuels; for instance, unburnt fuels from fuel loading and unloading operations, refuelling and liquid spillages.

"Some airborne organic compounds, such as benzene, which increase the risk of cancer, have been recorded at petrol stations at above the average levels for urban areas where traffic is the primary source of emission," UK's Telegraph quoted Doval as saying.

**Study details**
For their study, the research team measured the levels of 'typical traffic' pollutants in different urban parts of Murcia, and calculated the quotients for the levels of an aromatic compound (benzene) and a hydrocarbon (n-hexane) at three petrol stations, according to the Telegraph report, citing a Murcia university statement.

"Some airborne organic compounds -- such as benzene, which increases the risk of cancer -- have been recorded at petrol stations at levels above the average levels for urban areas where traffic is the primary source of emission," ScienceDaily quoted Doval as saying.

"In the three cases, we obtained maximum distances of influence of close to 100 metres, although the average distance over which this contamination has an effect is around 50 metres," said co-researcher Enrique González, according to the site.

**Impact depends on number of gas stations**
However, the distance at which the service stations stop having an impact depends on the number of petrol pumps, the amount of fuel drawn from them, traffic intensity, structure of the surroundings, and weather conditions.

"The more contaminated the zone surrounding the petrol station as a result of other causes (traffic), the lower the impact of the two pollutants at the service station," concluded the study authors.

The findings appear in the 'Journal of Environmental Management.'

| | |
|---|---|
| Nr. Ref./Broj Ref.: 07/NAF | Nr.Prot./Broj Prot.: 3701 |
| Nr. i faqeve/Broj Stranica: 1 | Data/Datum: 24.05.11 |

Prishtinë / a

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRI A E TREGTISË DHE INDUSTRISË
MINISTARSVO TRGOVINE I INDUSTRIJE
MINISTRY OF TRADE AND INDUSTRY

**Zyra për licencim rregullim dhe vëzhgim të sektorit të naftës në kosove**

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **REFERENCË:** | | | | | |
| **PËR/ZA/TO:** | Kadri Krasniqi/ Ferizaj | | | | |
| **CC:** | | | | | |
| **PËRMES/PREKO/THROUGH:** | | | | | |
| **NGA/OD/FROM:** | Ramdan Buzhala, drejtor i Zyres për licencim, rregullim dhe vëzhgim të sektorit të naftës në Kosovë | | | | |
| **TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:** | Përgjegje në letrën e datës | | | | |
| **Nr. i zyrës: Br. kancelarije: Room No.:** 116 | **Lokacioni: Kucni: Extension:** | Rr Muharrem Fejza,p.n, Lagja e Spitalit, Prishtine Tel: +381-38200 36531; | **Data: Datum: Date:** | 24.05.2011 | |

I nderuari z. Krasniqi,
I referohem letrës suaj me numer reference 07/NAF 3665 të datës 23 maj 2011 ku me anë të se ciles letër ju ankoheni lidhur me ndertimin e pompës se naftës dhe derivateve të saj nga z Tahir dhe Naser Malokut nga Ferizaj ne rrugën Naim Beka p.n. ne Ferizaj

Ne ju informojmë se Zyra për licencim rregullim dhe vëzhgim të sektorit të naftës në Kosove, nuk ka autoritetin që të ndërhyj në kompetencat e Komunës rast për dhënien apo mosdhënien e lejeve të ndërtimit për objekte çoftë ato banimi apo afariste, kur dihet fakti se Komuna ka Drejtoritë e caktuara kompetente të cilat merren me këtë çështje.

Gjiithashtu ju informojmë se Zyra për licencim rregullim dhe vëzhgim të sektorit të naftës në Kosovë, mbi bazën e ligjit mbi tregtië me naftë dhe derivate të saj nr 03/L-138, lëshon licenca vetëm për ushtrimin e veprimtarisë në sektorin e naftës dhe atë në rastet kur plotësohen kushtet dhe kriteret për licencim, e jo për ndërtimin e objektit (pompës së benzinës) e cila është në kompetencë ekskluzive të komunës.

Prandaj , ju këshillojmë që për sa i përket qështjes së ndërtimit të pompës të i drejtoheni komunës.

Me nderime
Ramadan buzhala
Drejtor i zyres për Licencim, Rregullim dhe Vëzhgim të sektorit të naftes në Kosove
Ministria e Tregtisë dhe Industrise

POMPA E BENZINES NE FERIZAJ Rruga"Naim Beka" ESHTE NDERTUAR NE KUNDERSHTIM ME LIGJIN DHE ATE/**LIGJI Nr.2003/14-Ligji per Planifikimin Hapsinor,**

**E SIDOMOS NE KUNDERSHTIM ME**
**LIGJIN Nr.2004/15 PER NDERTIMIN**

Pompa e Benzines ne Ferizaj,Rruga"Naim Beka"
Eshte ndertuar ne kundershtim me Nenin 23 pikat prej 1-6,Nenit 26 perj 1 deri ne 3 te te njejtit **Ligj per Planifikimin Hapsinor /LIGJI Nr.2003/14-.**

*Prokurorit Publik ia ofroj ligjin perkates.*

Pompa e Benzines ne Ferizaj,Rruga"Naim Beka" eshte ndertuar ne kundershtim me Nenet 33,34 pika 1,Neni 36,38,Nenit 40 pikat nga 1 deri n4,Nenit 49,Nenit 51,53,59,60,63,Nenit 64, i **LIGJIT Nr.2004/15 PER NDERTIMIN.**

*Prokurorit Publik ia ofroj ligjin perkates.*

Se i pandehuri ne rastin konkret *dyshohet se e ka kryer Vepren Penale e cila i vehet ne barre nga neni 339 par.3 lidhur me Par.1 te KPK-se*, flasin me se miri Dispozitat ligjore te neneve:59,60,63,Nenit 64, i **LIGJIT Nr.2004/15 PER NDERTIMIN,me te cilen shifet se i pandhuri-PERSONI I AUTORIZUAR nuk i ka permbushur detyrat zyrtare Konform nenit 59 dhe 60,e sidomos Nenit 63 e 64 te LIGJIT Nr.2004/15 PER NDERTIMIN,pra NUK I KA PERMBUSHUR detyren e vet nga se ne cilesine e Personit Zyrtar ka pasur obligim ligjor qe te PEZULLOJ NDERTIMIN E POMPES SE BENZINES NE KUNDERSHTIM ME LIGJIN,MADJE NE KUNDERSHTIM ME Nenin 64 te LIGJIT Nr.2004/15 PER NDERTIMIN KA PASUR OBLIGIM LIGJOR QE OBJEKTIN E NDERTUAR PA LEJE NDERTIMI EDHE TA RRENOJ(GJE QE PERSONI I AUTORIZUAR KETE DETYRE NUK E KA BERE).Prova eshte FAKT NOTOR(SEPSE ASAJ DITE E SOT OBJEKTI NE FJALE indertuar ne kundershtim me ligjin ME RREZIK PERMANENT PER JETE PER FAMILJET PER RRETH) POMPA E BENZINES PUNON PA LEJE NDERTIMI perkunder Njoftimit me Goje dhe me shkrim (dhe ate disa here) qe ia kam bere te pandehurit.**

**Prandaj mbi kete baze kam dyshim te bazuar se i pandehuri ka kryer** *Vepren Penale Shperdorim i Pozites ose i autorizimit nga neni 339 par.3* ***lidhur me*** *par.1 te Kodit Penal te Kosoves.*

REPUBLIKA E KOSOVES - PROKURORIA E SHTETIT - DRZAVNI TUZILAC
Pranuar 17-04-2012 Primljeno
Nr./Br. /
PRISHTINË - PRIŠTINA

*I demtuari*
*Kadri Krasniqi*
*Rr"Naim Beka" p.n.-Ferizaj*

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

DREJTORIA PËR URBANIZËM ,PRONË,KADASTËR,GJEODEZI DHE MJEDIS
UPRAVA ZA URBANIZAM , IMOVINU, KADASTAR,GEODEZI I OKOLINE
DEPARTMENT OF URBAN PLANING, PROPERITY, CADASTRE ,GEODEZY AND ENVIRONMENT

| | |
|---|---|
| DATA/DATUM/DATE | 19.01.2010 |
| NR/BR. | 03-zyrtarisht |

| | |
|---|---|
| PËR/ZA/TO | Kadri Krasniqi |
| PËRMES/PREKO/RTHROUGH | |
| NGA/OD/FROM | Qazime Vata, Drejtor i Drejtorisë |
| LËNDA/PREDMET/SUBJECT | **Njoftim** |

Pas shqyrtimit të kërkesës tuaj nr. 3-351-415 të datës 14.01.2010, me të cilën keni kërkuar që të njoftoheni në lidhje me ndërtimin e pompës për karburante në fqinjësi tuaj në Rr : »Naim Beka » Drejtoria për Urbanizëm,Pronë, Kadastër,Gjeodezi dhe Mjedis lëshon këtë :

**NJOFTIM**

Pompa për karburante në Rr : »Naim Beka » ,nuk është e pajisur me leje të ndërtimit.
Kërkesa për Leje Urbane nr.3-350-10656 e parashtruar nga z. Tahir Maloku më datë 01.12.2009 është shqyrtuar dhe me datë 16.12.2009 është njoftuar që nuk mundë të pajiset me leje ndërtimi.
Poashtu ju njoftojë që Drejtoria për Urbanizëm,Pronë, Kadastër,Gjeodezi dhe Mjedis nuk është kompetente për objektet të cilat ndërtohen pa leje .
Në kërkesën tuaj nr. 03-7-7091 të datës 17.07.2009 ju keni marrë njoftim nga Drejtoria për Urbanizëm,Pronë, Kadastër,Gjeodezi dhe Mjedis të datës 21.07.2009.

Provë: Kopja e njoftimit të cilin e keni pranuar

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING

Njësia Org. / Org. Jedinice / Org. Unit: 115
Nr. Prot.: 85-2/11
Nr Faqeve / Br. Stranica / No. Pages: 035
Data / Datum / Date: 16/02/2011
Prishtinë / a

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria – Vlada - Government*

***Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor***
***Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja***
***Ministry of Environment and Spatial Planning***

Zyra e Sekretarit të Përhershëm / Kancelarija Stalnog Sekretara / Office of the Permanen Secratary

| | |
|---|---|
| DATË/A: | 14.02.2011 |
| REFERENC-Ë: | 11-INS-MH-8-2 |
| PËR/ZA/TO: | Kadri Krasniqi, rr.Naim Beka, p.n. Ferizaj |
| CC: | |
| PËRMES/PREKO/THROUGH: | |
| NGA/OD/FROM: | Arben Çitaku u.d.Sekretarin Permanent |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Pergjigjeje në lidhje me inspektimin e Pompes se benzines "FITORJA", Rr. Naim Beka, Ferizaj, ne baze te ankeses se qytetarit, Kadri Krasniqi, Nr.85/11, te dates 24.01.2011 |

Bashkangjitur keni Pergjigjejen në lidhje me inspektimin e Pompes se benzines "FITORJA", Rr. Naim Beka, Ferizaj, ne baze te ankeses se qytetarit, Kadri Krasniqi, Nr.85/11, te dates 24.01.2011

Me respekt,



Adresa: rr."Nazim Gafurri" nr.31 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon/Faks: + 381 38 517 638; +381 38 517 538
http://www.ks-gov.net/mmph, E-mail: zsp.mmph@ks-gov.net

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria – Vlada - Government*

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor*
*Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja*
*Ministry of Environment and Spatial Planning*

*Zyra e Sekretarit të Përhershëm / Kancelarija Stalnog Sekretara / Office of the Permanen Secratary*

## Pergjigjëje në lidhje me inspektimin e Pompës së benzinës "FITORJA", Rr. "Naim Beka", Ferizaj; në bazë të ankesës së qytetarit, Kadri Krasniqi, Nr.85/11, të datës 24.01.2011

Në bazë të ankesës Nr.85/11, të datës 24.01.2011,nga qytetari Kadri Krasniqi, me banim ne Rr."Naim Beka", p.n. Ferizaj; drejtuar MMPH-së, Inspektorati i MMPH-së, ne perberje nga inspektoret: Mustaf Hyseni, Refik Rexhepaj dhe Vehbi Ejupi, në bazë të Ligjit për mbrojtjen e mjedisit Nr.03/L-025; Ligjit te VNM-se Nr.03/L-214; Ligjit te Planifikimit Hapesinor Nr. 2003/14 ,si dhe Ligjit te Ndertimit Nr.2004/; me datë 02.02.2011, ka dalë në teren në lokacionin e lartëshënuar dhe pas vizites detale inspektive ka konstatuar gjendjen e faktorve mjedisorë në objektin ne fjale dhe per rreth objektit.

Me kerkese te inspektoratit operatori i kompanise "Fitorja", Ferizaj, ka prezentua dokumentacionin posedues-valid per objektin e Pompes se Benzines ne fjale.

Certifikaten e biznesit nr.70410455; Vendimin per Pelqim Mjedisor per karburante te gazta Nr.09.2232/3-ZSP-184/10,te dates: 27.05.2010; Pelqimin Mjedisor per karburante te lengeta, Nr. 09/2232/2-ZSP-21/10, te dates: 08.02.2010 ;Pelqim nga Departmenti i Menaxhimit te Emergjencave Nr.23/2010; Licencen per biznes ne sektorin e naftes, Nr. 1333, te dates 23.04.2010.

Sipas vëzhgimeve në teren dhe dokumentacionit te prezentuar nga kompania ne fjale, inspektorati ka konstatuar se Stacioni i karburanteve"Fitorja", Rr. "Naim Beka", Ferizaj , eshte ne funksion te distribuimit me pakice te karburanteve te gazet dhe te lenget.



Adresa: rr."Nazim Gafurri" nr.31 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon/Faks: + 381 38 517 638; +381 38 517 558
http://www.ks-gov.net/mmph, E-mail: zsp.mmph@ks-gov.net

Bazuar në dokumentacionin e përmendur dhe faktorët mjedisorë ,inspektorati i MMPH-se konstaton se operatori në fjalë me veprimtarinë e vetë ,për momentin nuk paraqet qrregullim evident mjedisor për komunitetin dhe ekosistemin.

Operatori Stacioni i karburanteve SHPK."Fitorja", Rr. "Naim Beka", Ferizaj,me procesverbal Nr.11-INS-MH-8-2, është urdhërua të veproj sipas Projektit për VNM dhe kushteve të parashtruara në Pelqimin Mjedisor per karburante te gazta Nr.09.2232/3-ZSP-184/10,te dates: 27.05.2010; Pelqimin Mjedisor per karburante te lengeta, Nr. 09/2232/2-ZSP-21/10, te dates: 08.02.2010 ; në të cilin në mënyrë të prerë janë përcaktuar kushtet që operatori me rastin e e punes-veprimit në punishtë duhë t'i rrespektoj dhe zbatoj me përpikëri.

Kushtet e Pelqimit mjedisor janë:

- Gjatë punës duhet të ndërmerren të gjitha masat për evitimin e ndotjes se mjedisit ne tersi(toka,uji dhe ajri),e posaqerishte evitimin e derdhjes se vajrave te makinave, evitimin e derdhjes se karburanteve te gazet dhe te lenget gjatë furnizimit të makinave me karburant.
- Të mirembahet sistemi i kanaleve dhe rigolave për grumbullimin e ujërave nga sipërfaqet operacionale gjere ne seperatorin e vajrave dhe te veprohet në pajtim me rregullativen ligjore per mbrojtjen e ujerave.
- Të vendosen pajimet adekuate për vendosjen e mbeturinave të ngurta dhe lëngta.
- Aplikanti përpos kushteve të lartëshënuara duhët tu përmbahet edhe kushteve tjera të paraqitura në raportin e VNM-së.

Nëse nga operatori në fjalë gjatë operimit nuk plotësohen kushtet e lart cekura , Pëlqimi mjedisor do të anulohet (merret).

Në aspektin e fushës së rregullativës ligjore të ndërtimit lënda është analizuar në tërsi dhe pas inspektimit të objektit në teren, inspektorati konstaton se objekti është i finalizuar dhe është në funksionim . Moszbatimi i të gjitha urdhëresave , vendimeve ,dhe ndalesat të ndërmara nga ana e inspektoratit të komunës ndaj objektit në fjalë , mbetet si objekt shqyrtimi të kësaj lënde në gjykatën Kjomunale në Ferizaj.

Inspektorët e MMPH-së :

- Mustaf Hyseni inspektor i mjedisit
- Vehbi Ejupi inspektor i mjedisit
- Refik Rexhepaj inspektor i ndëretimit



Adresa: rr."Nazim Gafurri" nr.31 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon/Faks: + 381 38 517 638; +381 38 517 558
http://www.ks-gov.net/mmph. E-mail: zsp.mmph@ks-gov.net

Përgjigjigja ka qenë se **mund të rrezikohemi në një largësi të tillë**. Nepse sipas standardeve dhe rregullave ligjore nuk lejohet ndërtimi i pompave të benzinës në vendbanim në një largësi të tillë prej 5 metrave. Dhe se minimumi i largësisë duhet të jetë 25 metra dhe atë duhet të i përmbush standardet e ndërtimit [illegible] izolimin special që duhet të bëhet rezervuar.

Megenëse dyshojmë edhe përkundër [illegible] të Drejtorisë së ndërtimit kësaj pompe nuk do të pajiset me leje ndërtimi dhe se nuk do të i lejohet ndërtimi [illegible] kryefamiljar nga organet kompetente Drejtoria per Urbanizëm e kuvendit Komunal dhe Inspekcioni që të i ndermarrin të gjitha masat preventive në kuadër të kompetencave dhe kahjive ligjor që të ndalet në ndërtimin e kësaj Pompe.

Nëse nuk ndalohet ndërtimi i kësaj pompe nga organet komunale kërkoj [illegible] me poshtë.

**Të më lëshojnë dëshmi me shkrim e cila duhet të jetë një Vendim në të cilin organet do të na vertetonin –apo dëshmonin se ndërtimi i pompës së benzinës nga ndërtuesi Tahir Maloku afër shtëpisë sonë nuk do të na rrezikoj familjen dhe shtëpinë si dhe objektet tjera përcjellëse.**

Megenëse jemi informuar nga ekspertet për rrezikshmërin e ndërtimit të kësaj pompe të karburantit do të detyrohemi të shëmgulemi nga shtëpia nëse [illegible] ndërtimi dhe nëse organet komunale nuk kontribojnë për pengimin e ndërtimit [illegible] të detyruar dhe të kërkojmë ndihmë nga organet më të larta.

Përveç të kësaj kërkese ta bashkangjes fotografitë të cilat janë bërë nga [illegible] nga lidhja si dëshmi që tregojnë [illegible] ndërtimit të gropimit të rezervuarit.

Ferizaj më 17.07.2009

Parashtruesit e kërkesës

Kadri Krasniqi Krasniqi 17.07.09

Sulejman Krasniqi

Rruga Naim Frashëri

Ferizaj